



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 148, Datë 28.05.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “POWER ENERGY” SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 25 MW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1608/1 prot., datë 26.05.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 MW”,

Konstatohet se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “POWER ENERGY” sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.08.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale 3038, Fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, i ndryshuar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1608 prot., datë 15.05.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e Aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 25 MW.
- Nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 310, datë 04.06.2025 dhe Kontratës nr. 5129 rep., nr. 2337 kol., datë 13.06.2025 të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëria ka fituar të drejtën “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 25 MW, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesionit, në Zonën Kadastrale 3038, Fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “POWER ENERGY” shpk”.
- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores e po ashtu ka shlyer dhe pagesat e rregullimit.

2. Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 e Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas gërmave (a, c, d, e, f dhe g).
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, gëma “b” të Rregullores, shoqëria duhet të bëjë saktësimin përkatës të veprave ndihmëse dhe kapacitetit të secilës.
- Po ashtu, në kuadër të informacionit shtesë, vlerësohet t’i kërkohej shoqërisë të depozitohet një informacion mbi mënyrën se si parashikon financimin e investimit për vendosjen e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.
- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe MIE, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe shoqëria “Operatori Sistemit Transmetimit” (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.08.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 MW, duke shtuar veprat ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “POWER ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare e Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI